

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6526
E enjte, 3 shkurt 2022
çmimi 0.40

PDK-ja premtion
mbështetje për shqiptarët
në Maqedoni | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN
PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, DHE PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BE-SË PËR
DIALOGUN, MIROSLAV LAJÇAK, KANË PËRMBYLLUR VIZITËN TREDITORE NË KOSOVË

AKTUALE



GJASHTË VIKTIMA DHE MBI 2 500
RASTE ME COVID NË KOSOVË | F. 5

SHQIPËRIA PO VLERËSON MASAT
KUFIZUESE | F. 3

DARDAN MOLLIQAJ DËRGOHET NË
MBAJTJE | F. 4




EKONOMI



EMËROHEN BORDET E DREJTORËVE
TË TREPÇËS DHE KEK-ut | F. 8

KURTI VIZITOI AGJENCINË E
SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT
AJROR | F. 8

SPORT



CURRI PËR ZHVILLIMET NË FSHF:
NDËRHYRJA E POLITIKËS DO TË
NDIKOJË TE KOMBËTARJA | F. 10

SHBA-ja DHE BE-ja NUK DO TË IMPONOJNË MODELE PËR ASOCIACIONIN



I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguar special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë kërkuar prej Kosovës zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Në ditën e fundit të vizitës së tyre, ata kanë bërë me dije se nuk do të imponojnë ndonjë model të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Sipas tyre, Kosova dhe Serbia duhet t'i ofrojnë propozimet e tyre se si do të duhej të dukej ky asociacion

PDK-ja emëron
nënkryetaren dhe
drejtorët në komunën
e Prishtinës | FAQE 7



16 PERSONA PARAQITEN SI VIKTIMA
TË UÇK-së NË GJYKATËN SPECIALE,
PRITET TË REFUZOHEN TË GJITHË
| FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja e gatshme të diskutojë me Rusinë për trupat dhe raketat

UASHINGTON, 2 SHKURT - Shtetet e Bashkuara janë të përgatitura për të zhvilluar bisedime me Rusinë për një marrëveshje reciproke rreth raketave tokësore dhe forcave luftarake në Ukrainë, sipas disa dokumenteve të publikuara nga revista spanjolle "El Pais".

Dokumentet, të cilat, sipas gazetës, janë pjesë e përgjigjeve të Uashingtonit dhe NATO-s ndaj kërkesave të Rusisë për siguri, kanë ofruar mundësinë e kufizimit të incidenteve ushtarake, si dhe ta sigurojnë Moskën se raketat Tomahawk nuk do të instalohen në Rumani dhe Poloni, vende anëtare të aleancës. "NATO-ja është aleancë për mbrojtje dhe nuk përbën kërcënim për Rusinë", është thënë në dokumentin e Uashingtonit. "Ne gjithmonë kemi qenë në kërkim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë në zonën euroatlantike dhe të një Evrope të lirë dhe në paqe. Këto janë synimet dhe vizioni ynë".

El Pais nuk ka treguar si i ka siguruar dokumentet, derisa agjencia e lajmeve "Reuters" ka cituar NATO-n dhe Kremlinin të kenë thënë se nuk mund ta komentojnë informacionin e publikuar nga gazeta spanjolle.

Dokumentet i janë dorëzuar Kremlinut muajin e kaluar, pas tentimeve për t'i ulur tensionet në mes të Moskës dhe Perëndimit lidhur me pozicionimin e më shumë se 100 mijë trupave afër kufirit me Ukrainën.

Rusia ka mohuar se pozicionimi i trupave është shenjë për pushtim eventual.

Megjithatë, presidenti rus Vladimir Putin ka kërkuar garanci se NATO-ja nuk do të lejojë anëtarësimin e Ukrainës në të ardhmen në këtë aleancë.

Moska, po ashtu, ka sugjeruar se nuk do t'i tolerojë trupat e NATO-s dhe infrastrukturën e saj në vendet si Rumania, Bullgaria dhe Gjeorgjia.

Si Uashingtoni, ashtu edhe NATO-ja kanë hedhur poshtë mundësinë që ndonjë shtet ta diktojë politikën e aleancës sa i përket anëtarësimit. "Ne besojmë fuqishëm se tensionet dhe mospajtimet duhet të zgjidhen përmes dialogut dhe diplomacisë, dhe jo përmes kërcënimit për përdorim të forcës", është thënë në dokumentet e publikuara nga El Pais.

Zëdhënësi i Kremlinut, Dmitry Peskov, nuk ka komentuar këto



raportime. "Ne nuk kemi bërë asgjë publike. Nuk duam të komentojmë për këtë gjë", ka thënë ai.

Peskov ka thënë se Rusia planifikon t'i luftojë sanksionet amerikane dhe t'i zvogëlojë pasojat e tyre, si dhe i ka bërë thirrje Shtëpisë së Bardhë që të mos "rrisë tensionet" në Evropë. Presidenti rus, Vladimir Putin dhe kryeministri britanik, Boris

Johnson, ishte planifikuar që të bisedonin më 1 shkurt, mirëpo Johnsoni e ka shtyrë takimin për shkak të problemeve politike të brendshme.

Para takimit, një zyrtar i lartë rus në Kombet e Bashkuara e ka përshkruar diplomacinë britanike si "të pavlerë". "Ka gjithmonë hapësirë për diplomaci, mirëpo sinqerisht ne nuk i besojmë diplomacisë britanike", ka thënë

Dmitry Polyanskiy, zëvendësambasador në Kombet e Bashkuara, në një intervistë për "Sky News".

Nëse Rusia pushton Ukrainën, kjo nuk do të ishte hera e parë.

Rusia ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014.

Ky vend, po ashtu, mbështet rebelët në konfliktet në rajonet lindore të Ukrainës, në të cilat kanë vdekur rreth 14 000 persona.

Norvegjia dhe Franca heqin shumicën e kufizimeve kundër pandemisë



OSLO, 2 SHKURT - Norvegjia është bërë shteti i dytë skandinav që ka hequr shumicën e kufizimeve për koronavirus pavarësisht prej rritjes së shkallës së infektimit si pasojë e variantit Omicron.

Autoritetet norvegjeze kanë thënë se shoqëria "duhet të jetojë" me virusin, derisa edhe Franca ka vepruar ngjashëm. Omicroni ka rritur numrin e të infektuarve në Norvegji, mirëpo numri i pacientëve të shtrirë nëpër spitale nuk është rritur. "Më në fund kemi arritur në

pikën kur mund ta heqim shumicën e masave shëndetësore me të cilat na është dashur të jetojmë këtë dimër", ka thënë ministri norvegjez, Jonas Gahr Store, në një konferencë për medie. Më shumë se 781 000 raste dhe 1 440 viktima me koronavirus janë regjistruar në Norvegji prej shpërthimit të pandemisë.

Në këtë shtet pothuajse 91 për qind e popullsisë është e vaksinuar plotësisht. Norvegjia ka marrë këtë vendim

pas Danimarkës, e cila është bërë shteti i parë i Bashkimit Evropian që ka hequr të gjitha kufizimet për luftim të pandemisë, pavarësisht prej shifrave rekorde të infektimit.

Ndërkohë Franca ka marrë vendim që nga 2 shkurti të hiqet masa për vendosje të maskës në ambiente të jashtme.

Është hequr edhe limiti për numrin e personave që mund të marrin pjesë në koncerte, ndeshje sportive dhe ngjarje të tjera.

Turqia tërheq trupat e 12 emigrantëve të ngrirë në kufi me Greqinë

ANKARA, 2 SHKURT - Ministri i Brendshëm i Turqisë, Suleyman Soyulu, ka thënë të mërkurën se autoritetet kanë gjetur 12 trupa, që besohet se janë të emigrantëve që u ngrinë për vdekje pranë kufirit të Turqisë me Greqinë. Ai ka shkruar në "Twitter" se 12 persona ishin në mesin e 22 emigrantëve që u kthyen në Turqi nga rojet kufitare greke. Soyulu ka theksuar se ata u gjetën

pranë pikës kufitare Ipsala midis Turqisë dhe Greqisë "pa këpucë dhe të zhveshur".

Ministri turk nuk dha detaje të mëtejshme, por akuzoi njësitë kufitare greke për sjellje "mizore" dhe Bashkimin Evropian për sjellje të butë ndaj Greqisë.

Turqia shpesh e akuzon Greqinë fqinje se po i kthen ilegalisht migrantët që duan të hyjnë në Evropë. Por, Greqia e

mohon akuzën.

Turqia është një pikë kalimi kryesore për migrantët nga Lindja e Mesme, Azia dhe Afrika që kërkojnë një jetë më të mirë në vendet e Bashkimit Evropian.

Shumica përpiqen të kalojnë në Greqi ose duke kaluar kufirin tokësor verilindor ose duke u ngjeshur në anije kontrabandë të drejtuara për në ishujt lindorë të Detit Egje.



16 persona paraqiten si viktimat të UÇK-së në Gjykatën Speciale, pritet të refuzohen të gjithë

HAGË, 2 SHKURT - Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave (VPO) ka përpiluar raportin e katërt të aplikacioneve të personave që janë paraqitur si viktimat të UÇK-së në rastin kundër ish-drejtesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Në këtë raport janë përfshirë gjithsej 16 aplikacione të personave që pretendojnë të jenë viktimat të UÇK-së në mënyrë direkte apo indirekte.

Të gjithë këta persona që janë paraqitur si viktimat të UÇK-së pritet të refuzohen për shkak se nuk kanë paraqitur prova të mjaftueshme.

Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave ka rekomanduar që të gjithë të paraqiturve t'u refuzohet aplikimi si viktimat të UÇK-së për shkak se, sipas kësaj zyre, ata nuk kanë paraqitur apo demonstruar mjaftueshëm se ngjarjet e pretenduara bien brenda parametrevë të kërkuara materiale, gjeografike dhe kohore të aktakuzave të konfirmuara. "VPO-ja vlerëson se aplikantët

nuk kanë demonstruar mjaftueshëm, 'prima facie' se ngjarjet e përshkruara në kërkesat e tyre bien brenda parametrevë materiale, gjeografike dhe kohore të akuzave të konfirmuara, siç përshkruhet në aktakuzën e konfirmuar të korrigjuar. Rrjedhimisht, VPO-ja i rekomandon gjyqtarit të procedurës paraprake që t'i refuzojë të gjitha kërkesat për pjesëmarrje si viktimat në procedurat e paraqitura me këtë raport të katërt", është thënë në kërkesën e VPO-së.

Parashtruesit e kërkesave për marrjen e statusit të viktimave të UÇK-së kanë pretenduar se janë viktimat indirekte të rrëmbimit dhe zhdukjes me forcë të familjarëve të tyre.

Më 5 nëntor të vitit 2020, ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë paraburgosur në Hagë pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale.

Në paraqitjen e tyre të parë para



trupit gjykues, ata janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Deri më tani janë mbajtur disa konferenca statutorë me qëllim të organizimit të shkëmbimeve

ndërmjet palëve. Fillimisht në këto seanca ish-komandantëve të UÇK-së u është lexuar aktakuza, ku ata kanë hedhur poshtë pretendimet e prokurorisë. Konferencat statutorë janë karakterizuar me

përplasje të avokatëve me përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorisë së Specializuar. Pala mbrojtëse ka akuzuar vazhdimisht prokurorinë për zvarritje të qëllimshme të procesit gjyqësor.

Shqipëria po vlerëson masat kufizuese



TIRANË, 2 SHKURT - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Shqipëri, Ogerta Manastirliu, ka deklaruar se është ende herët për ta shpallur fitoren ndaj virusit, duke theksuar se situata po monitorohet nga Komiteti Teknik i Ekspertëve për rivlerësimin e masave kundër Covidit.

E pyetur nga gazetarët për rishikimin e masave kundër Covidit, Manastirliu tha: "Është ende herët për ta shpallur fitoren, është ende herët për t'i lëshuar të gjitha masat jomjekësore por, nga ana tjetër, ajo çfarë duhet dhe çfarë po bëjnë vendet është një vlerësim epidemiologjik mbi bazën e situatës lokale dhe ka disa vende që kanë marrë vendimin për të lehtësuar këto masa. Sa iu përket masave tona, masat në Shqipëri janë masa që konsiderohen të intensitetit të ulët dhe mesatar. Situata po vlerësohet në mënyrë dinamike. Është aktualisht një

situatë që na bënë të jemi të kujdesshëm në raport me ata hapa që do të marrim sa i përket lehtësimit të masave", ka deklaruar Manastirliu.

Ministria e Shëndetësisë u shpreh se në Shqipëri mbizotëron qarkullimi i variantit Omicron, ndërsa foli edhe për situatën e të shtruarve në spitale.

Ministria e Shëndetësisë u shpreh se në vendin tonë mbizotëron qarkullimi i variantit Omicron, ndërsa foli edhe për situatën e të shtruarve në spitale. "Ne sot kemi mbi 18 mijë raste aktive të cilat janë në masën 98 për qind me variantin Omicron dhe, gjithashtu, situata në spitale është e qëndrueshme", ka thënë Manastirliu.

Ministria e Shëndetësisë bëri me dije se Komiteti Teknik do të mblidhet së shpejti për ta rivlerësuar afatin gjashtëmuor të dozës përforcuese dhe shkurtrimin e ditëve të izolimit.

Maloku vlerëson mbështetjen e Britanisë dhënë sistemit prokurorial

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, ka pritur në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott. Kryesuesi Maloku ka falënderuar ambasadorin Abbott për mbështetjen e vazhdueshme dhe shumë të

rëndësishme që Mbretëria e Bashkuar po jep për sistemin prokurorial në shumë fusha që lidhen me avancimin e këtij sistemi.

Gjatë këtij takimi kryesuesi Maloku e ka njoftuar ambasadorin Abbott me punën dhe veprimtarinë e KPK-së, aktivitetet që janë duke u zhvilluar dhe ato që

parashihet të realizohen gjatë vitit 2022, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, llogaridhënies, transparencës dhe pavarësisë së sistemit prokurorial.

Në anën tjetër, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, ka thënë se është mirënjohës për diskutimin e hapur dhe të sinqertë.





PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR DHE PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BE-SË PËR DIALOGUN, MIROSLAV LAJÇAK, KANË PËRMBYLLUR VIZITËN TREDITORE NË KOSOVË

ShBA-ja dhe BE-ja nuk do të imponojnë modele për asociacionin

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguar special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčák, kanë kërkuar prej Kosovës zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Në ditën e fundit të vizitës së tyre, ata kanë bërë me dije se nuk do të imponojnë ndonjë model të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Sipas tyre, Kosova dhe Serbia duhet t'i ofrojnë propozimet e tyre se si do të duhej të dukej ky asociacion

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

Prishtinë, 2 shkurt - I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka deklaruar se Kosova dhe Serbia duhet të jenë konstruktive në dialogun e Brukselit, duke zbatuar të gjitha marrëveshjet e arritura në këtë proces.

Në ditën e fundit të vizitës, ai ka thënë se BE-ja si ndërmjetësuese e dialogut dhe

as ShBA-ja si mbështetëse e dialogut nuk do të imponojnë modele të asociacionit të komunave më shumicë serbe. "Ne nuk kemi ardhur këtu me recetë propozimesh që do të donim t'i impononim. Në fakt, ne po kërkojmë nga të dyja palët [Kosova dhe Serbia] që të jenë konstruktive, t'i ofrojnë vizionet e tyre se si duhet të duket Asociacioni, pastaj të negociojnë prej aty në kuadër të dialogut", ka thënë Escobar në konferencën e përbashkët

për medie me të dërguarin special të BE-së për dialogun, Miroslav Lajčák.

Ai ka bërë me dije se modellet e asociacionit nuk duhet ta dëmtojnë sovranitetin e Republikës së Kosovës. "Nuk duhet të jenë ato modele që minojnë sovranitetin apo funksionalitetin e Kosovës. Pra, ne duhet të gjejmë një. Ato mund të gjenden, mund të negociohen dhe mund të dakordohen. Ky është qëllimi i dialogut. Nuk është qëllimi i

ShBA-së të imponojë një [model] ose të zgjedhë një, në emër të palëve", ka thënë Escobar.

Edhe i dërguar i BE-së për këtë proces, Miroslav Lajčák, ka thënë se askush nuk dëshiron Republikë Sërpska në Kosovë. "Nëse duam t'i japim fund ekzistencës së strukturave paralele [serbe në Kosovë], nëse duam transparencë në rrjedhat financiare, nëse duam rregulla të qarta në veri, këto mund të bëhen të gjitha brenda sistemit kushtetues dhe juridik të Kosovës", është shprehur Lajčák.

Ai u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të mos frikësohen nga procesi i dialogut. "Këshilla ime: Mos kini frikë nga diçka që nuk ekziston dhe askush nuk do

t'ua imponojë. Jini të sigurt në vetvete, të vetëdijshëm për faktin se ju jeni bashkudhëheqës në këtë proces dhe jeni partnerë të barabartë. Nuk ka absolutisht asnjë arsye për t'u frikësuar nga procesi që po zhvillohet me Serbinë dhe ne jemi këtu për të siguruar se çdo vendim që do të merret, do të bazohet në standardet dhe vlerat e normave evropiane", ka deklaruar Lajčaku.

Optimistë për marrëveshjen përfundimtare

Dy diplomatët i kanë vlerësuar si produktive takimet që i kanë pasur gjatë këtyre tri ditëve me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, opozitës dhe

Gjashtë viktima dhe mbi 2 500 raste me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të mërkurën janë regjistruar gjashtë viktima dhe 2 590 raste të reja me Covid-19. Rastet pozitive kanë dalë pas testimit të 12 259 mostrave.

Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 21.12 për qind.

Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar se edhe 2 952 persona janë shëruar derisa 33 538 persona janë ende aktivë me koronavirus.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion

doza të vaksinës. Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 806 268 persona apo 44 për qind e popullsisë.

Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë. Qeveria e Kosovës ka miratuar më 21 janar masa të reja për luftim të pandemisë. Sipas vendimit të qeverisë, qytetarët që hyjnë në Kosovë duhet të jenë të vaksinuar plotësisht dhe ta kenë edhe dozën përforcuese.

Ata që nuk kanë dozën përforcuese duhet të kenë test negativ të llojit PCR, të vlefshëm për 48 orë.

Kufizimi i qarkullimit do të aplikohet nga ora 22:00 deri në orën 05:00.



Dardan Molliqaj dërgohet në mbajtje

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës njoftoi se kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, pas arrestimit të martën, është dërguar në mbajtje prej 48 orësh. Sipas policisë, për kryetarin e PSD-së ekziston dyshimi i arsyeshem se i njëjti është përfshirë në rastin e sulmit ndaj personit zyrtar të ndodhur në protestën e së shtunës më 29 janar kundër shtrenjtimit të rrymës. "Policia e kishte kërkuar të njëjtin në adresat e banimit dhe nuk e kishte hasur në to. Të njëjtit i kishte lënë edhe një ftesë për paraqitje vullnetare, por i

dyshuari nuk e kishte përfillur", thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Në protestën e organizuar nga PSD-ja qytetarët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre ndaj propozimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për tarifën e reja të energjisë. PSD përmes një reagimi në rrjetet sociale e ka quajtur të panevojshëm arrestimin, duke e cilësuar të motivuar politikisht.

Në protestën e 29 janarit aktivistët e PSD-së kanë hedhur qirin dhe poçe elektrike në drejtim të qeverisë në shenjë revolte.

shoqërisë civile. Ata kanë shprehur optimizëm për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke treguar se kjo do të sjellë përfitime për të dyja palët. "Mendoj se në këtë rol si përfaqësues special është me rëndësi ta bëjë vizitën e parë në Kosovë për të treguar unitet, përkushtim ndaj dialogut, ndaj një të ardhme më të ndritshme si për Serbinë dhe Kosovën. Jemi takuar me udhëheqësit gjatë vizitës, kemi pasur takime shumë produktive. Në fund të këtij procesi shpresojmë se rezultati do të jetë një zgjidhje e mirë për të dyja vendet. Kam besim në mënyrën se si gjërat më duken dhe me përkushtimin e partnerëve tanë bashkë me mbështetjen e amerikanëve këtë proces do të arrijmë", ka thënë i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Edhe diplomati evropian beson se rezultatet e takimeve do të jenë pozitive. Sipas tij, dialogu i Brukselit nuk ka të bëjë me negociimin e statusit të Kosovës, por me negociimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. "Besojmë që normalizimi i marrëdhënieve jo vetëm që do t'i zgjidhë çështjet e pazgjidhura, por do të kontribuojë në stabilitetin në rajon, por do të sjellë përfitime për qytetarët. Do të krijojë vende punë, do ta zhvillojë ekonominë. Dy ditët e kaluara kanë qenë shumë produktive. E kemi bërë të qartë se ne i respektojmë parimet e Kosovës në dialog. Ne, po ashtu, kemi thënë se ne kemi pritur përparim më të shpejtë në dialog vitin e kaluar, por shpresojmë që të jetë kështu këtë vit", ka thënë Lajçaku, duke shtuar se të dy vendet janë të lodhur nga status quo-ja.

Kurti: Serbët e Kosovës duan drejtësi e punësim, jo asociacion

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar se serbët e Kosovës duan formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Në konferencën për medie, pas mbledhjes së qeverisë, ai ka thënë se asociacioni është kërkesë e Serbisë, që ka për qëllim të shkaktojë tensione në Kosovë. Sipas tij, serbët e Kosovës duan drejtësi dhe punësim. "Unë besoj se edhe serbët, porsiq shqiptarët, turqit, boshnjakët, egjiptianët, ashkalinjtë, gjithë qytetarët e Republikës kanë nevojë për drejtësi dhe punësim e jo për asociacionet të cilat na shtojnë tensionet, na i prishin raportet tona dhe e gëzojnë dikë në Beograd. Nuk ka qenë asnjëherë kërkesë e serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës duan drejtësi dhe punësim. Andaj, duhet t'i

dallojmë kërkesat që vijnë prej poshtë dhe kanë karakter demokratik e shoqëror, prej kërkesave që vijnë prej lart dhe kanë karakter jodemokratik e hegjeonik. Pra, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që kushtetutshmëria e ligjshmëria në gjithë territorin e Kosovës të respektohet e të zbatohet në mënyrë të plotë. Për të gjitha kërkesat e serbëve të Kosovës unë jam kryeministër edhe i tyre", ka thënë Kurti.

Ai ka deklaruar se Kosova dëshiron dialog për marrëveshje e jo dialog për dialog. "Kjo nënkupton se marrëveshja si marrëveshje për raportet tona, çfarë marrëdhënie do të kemi Kosova me Serbinë, e besojmë se duhet të jenë normale, patjetër në qendër ta kenë njohjen reciproke. Është një shteg i qartë, i saktë dhe i mirë për të cilin natyrisht kemi shprehur qëndrimet tona, por edhe qasjen tonë konstruktive", ka deklaruar Kurti.

Për marrëveshjen e asociacionit

që është arritur në Bruksel, ai ka thënë se ajo ka rënë në testin e Gjykatës Kushtetuese. "Ju e dini shumë mirë që Gjykata Kushtetuese më 2015 ka publikuar Aktgjykimin e vet me të cilin ka thënë se asnjëri prej shtatë kapitujve të asociacionit nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, rrjedhimisht ai asociacion nuk e ka kaluar testin e Gjykatës Kushtetuese", ka thënë Kurti.

Ai është shprehur i gatshëm për vazhdimin e dialogut, kurdo që BE-ja e fton në Bruksel. Gjatë qëndrimit treditor në Kosovë, Ecobar dhe Lajçak kanë zhvilluar takime me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, liderët e partive opozitare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Pas përfundimit të vizitës në Kosovë, dy diplomatët kanë udhëtuar për në Beograd, ku do të takohen për përfaqësuesit e Serbisë për të diskutuar rreth vazhdimin të procesit të dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

Spitali i Gjilanit vitin e kaluar ka ofruar mijëra shërbime mjekësore

GJILAN, 2 SHKURT (ER) - Stafi shëndetësor në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit vitin e shkuar ka ofruar mijëra shërbime mjekësore për pacientët e sëmurë, mes sfidave dhe vështirësive që solli pandemia Covid-19. Mjekët kirurgë, bashkë me anesteziologë dhe pjesën

tjetër të stafit përcjellës, kanë kryer 1 253 operacione të natyrave të ndryshme gjatë vitit 2021.

Në harkun kohor prej 12-muajsh në Spitalin e Gjilanit janë realizuar 1 401 lindje, prej tyre 471 me operim.

Brenda periudhës janar-

dhjetor janë kryer edhe 140 261 vizita ambulatore, 47 380 vizita diagnostike, janë trajtuar 26 968 raste në emergjencë dhe janë bërë 2 510 analiza laboratorike. Sa iu përket shërbimeve radiologjike, janë bërë 1 716 CT, 1 890 ultrazë dhe 16 842 radiografi.



Kryetari i Gjilanit emëron drejtorët e drejtorive komunale

GJILAN, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka publikuar emrat e drejtorëve të rinj për mandatin katërvjeçar të qeverisjes në këtë komunë. Leonora Morina-Bunjaku është emëruar nënkryetare e komunës.

Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Doruntina Hasani; drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kushtrim Zeqiri; drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Riad Rashiti; drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Selvete Sylejmani; drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mentor Mihovci; drejtor

i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bejtullah Osmani; drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Bajram Isufi; drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ali Arifi; drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, Enver Shabani. "Jemi në fazën përfundimtare që të vendosim emërimet për nënkryetarin për Komunitete, Drejtorinë e Pronës, Kadastrës dhe Gjeodezisë, Drejtorinë e Inspeksionit dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ky ekip do të plotësohet gjatë ditëve në vijim", ka thënë Hyseni.



Komuna e Rahovecit arrin marrëveshje me KFOR-in për furnizim me energji diellore të palestrës "Mizahir Isma"

RAHOVEC, 2 SHKURT (ER) - Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtori i Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi dhe Afrim Dina, drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, kanë arritur marrëveshje me KFOR-in italian për instalimin e sistemit

për furnizim me energji diellore të palestrës "Mizahir Isma".

Ky është projekti i parë i këtij lloji që do të instalohet në objektet komunale, në këtë mënyrë do të krijohen kushte më të volitshme për sportistët tanë dhe do të

bëhet kursimi i buxhetit komunal për vitet në vazhdim.

Mirëmbajtja e palestrës "Mizahir Isma" në qytetin e Rahovecit ka një kosto shumë të lartë dhe përmes këtij projekti do të ulët kostoja e mirëmbajtjes.

Idrizi premteton mbështetje për organizatat kulturore dhe artistike të Mitrovicës

MITROVICË, 2 SHKURT (ER) - Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit nga Rrjeti i Organizatave Kulturore (RROK) nga Mitrovica. Gjatë këtij takimi janë shkëmbyer shumë ide për projekte dhe agjenda të përbashkëta kulturore që priten të realizohen nga bashkëpunimi me organizatat kulturore dhe shoqëritë civile.

Me këtë rast, drejtoresha Idrizi ka

theksuar se bashkëpunimi dhe qasja gjithëpërfshirëse nga ana e drejtorisë në raport me shoqëritë civile nuk do të mungojë asnjëherë. "Vetëm me angazhim të përbashkët Mitrovicës mund t'ia kthejmë epitetin si djep i kulturës", ka deklaruar Idrizi.

Më tutje, drejtoresha e DKRS-së ka potencuar se organizatat kulturore dhe artistët mitrovicas do ta kenë përkrahjen institucionale dhe do të gëzojnë trajtim dinjitoz.



Nura liron nga pagesa e muajit shkurt prindërit e fëmijëve në çerdhen e qytetit

SKENDERAJ, 2 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka liruar nga pagesa e muajit shkurt prindërit e fëmijëve në

çerdhen e qytetit. "I kemi liruar nga pagesa mujore për muajin shkurt të gjithë prindërit e fëmijëve të institucionit parashkollor 'Nëna Zahide', si

kompensim i periudhës dhjetëditore kur çerdhja ishte mbyllur për shkak të rasteve të infeksionit nga virusi Covid-19, por edhe për t'i ndihmuar

sadopak familjet në këtë fazë jo të lehtë të pandemisë. Sa më shumë kujdes, aq më pak raste!", ka shkruar Nura në llogarinë e vet në "Facebook".



PDK-ja emëron nënkryetaren dhe drejtorët në komunën e Prishtinës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 SHKURT - Nënkyetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Uran Ismaili, ka paraqitur ekipin drejtues të kësaj partie në komunën e Prishtinës. Në një konferencë për medie, Ismaili ka treguar që PDK-ja ka emëruar për herë të parë një grua të përgatitur profesionale dhe me vullnet për angazhim në shoqëri si nënkryetare të kryeqytetit. Ai ka paraqitur edhe ekipin e katër drejtorëve nga radhët e PDK-së për katër vitet e ardhshme.

Ismaili ka thënë se të gjithë të emëruarit në këto pozita janë figura të dëshmuara, profesionistë dhe me integritet, të cilët me angazhimin e tyre do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve të

Prishtinës.

Në rolin e nënkryetares së parë grua të Prishtinës, PDK-ja ka emëruar Donjeta Sahatçiu, një profesioniste të dëshmuar për shumë vjet në sferën e menaxhimit, teknologjisë, komunikimit strategjik dhe ngritjen e kapaciteteve.

Në dhjetë vitet e fundit Sahatçiu ka udhëhequr kompaninë "Rrota", një ndër kompanitë lidere në Kosovë për teknologji dhe komunikim digjital, në rolin e drejtoreshës ekzekutive dhe si bashkëpronare. Sahatçiu ka studiuar për menaxhim, ekonomi dhe politika publike në RIT Kosovo, ku edhe është përzgjedhur studente e gjeneratës (2012) dhe menaxhim dhe administrim biznesi (eMBA) në Sheffield University. Për shumë vjet me radhë Sahatçiu ka qenë

promotore e digjitalizimit, rritjes së cilësisë në arsim dhe qasjes së të rinjve në tregun e punës. Ajo është mentoruese e ekipeve të reja start-up dhe bizneseve në rritje. Si konsulente e certifikuar në transformimin digjital ka ndihmuar edhe në fuqizimin e grave në fushën e teknologjisë.

Sahatçiu, gjithashtu, është zgjedhur dhe ka shërbyer vullnetarisht në misionin e disa organizatave.

Gjatë kësaj konference Ismaili ka prezantuar edhe katër drejtorët nga radhët e PDK-së.

Ilirik Musliu do të jetë drejtor i Shërbimeve Publike. "Gjithmonë kam besuar që shërbimet në sektorin publik duhet të kenë mendësinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e shërbimeve në sektorin privat. Me logjikën që

qytetari i Prishtinës të jetë në qendër, shërbimet të jenë të shpejta dhe pa arsytetime, kam vendosur që këtë drejtori t'ia besoj Ilirikut. Ai ka studiuar për menaxhim biznesi dhe është ndërmarrës i suksesshëm që ka menaxhuar disa prej kompanive më të suksesshme në Kosovë", ka thënë ai.

Drejtoreshë e Arsimit do të jetë Besianë Musmurati.

Ismaili ka treguar se Besiana ka përvojë shumëvjeçare në menaxhim dhe e njuh mirë shërbimin publik dhe politikën publike. "Ajo ka qenë shefe e kabinetit tim në Ministrinë e Shëndetësisë, ku së bashku kemi punuar për reformimin e këtij sektori. Për më tepër, Besiana ka shërbyer si diplomate në ambasadat e Kosovës në

Uashington D.C. dhe Bruksel. Ka qenë promotore e rritjes së cilësisë në arsim, dhe gjatë punës së saj në Uashington D.C. ka ndihmuar në organizimin e panairëve që kanë pasur për qëllim t'i fuqizojnë lidhjet në mes të Kosovës dhe ShBA-së në fushën e arsimit", ka thënë Ismaili.

Ai ka theksuar se është i lumtur që ekipit të udhëheqjes së Prishtinës i është bashkuar edhe Granit Rugova si drejtor i Sportit. Drejtor i Bujqësisë do të jetë Plator Gërdovci. "Platori është djalë i Prishtinës, ekonomist me shkollim dhe i zëshëm për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit në Kosovë", ka thënë nënkryetari i PDK-së. Gjatë ditëve në vijim Ismaili pritet ta emërojë edhe udhëheqësin/en e Drejtorisë së Kulturës.

PDK-ja premtonte mbështetje për shqiptarët në Maqedoni

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të mërkurën në takim Ziadin Selën, kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, kryetarin e komunës së Gostivarit, Arben Taravari dhe kryetaren e grupit parlamentar të kësaj partie në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, Ilire Dauti, me të cilët

ka diskutuar për tema aktuale të interesit shtetëror dhe kombëtar. "Përveç temave politike që preokupojnë qytetarët e dy vendeve tona, biseduam edhe për çështjen e masave kufizuese të vendosura nga Qeveria e Kosovës për të mos lejuar hyrjen e shtetasve të huaj pa dozën e tretë të vaksinës anti-Covid, ku shprehëm shqetësimin për pengesat që po u shkaktohen shqiptarëve

të Maqedonisë së Veriut gjatë hyrjes në Kosovë. Ne kemi reaguar në vazhdimësi lidhur me këtë duke kërkuar që Qeveria e Kosovës t'i shqyrtojë dhe t'i ndryshoj këto kufizime", ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se si çdoherë, Partia Demokratike e Kosovës do të angazhohet për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, në veçanti me shqiptarët atje.



Kurti vizitoi Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, vlerësohet si domosdoshmëri zgjatja e pistës

LIPJAN, 2 SHKURT (ER) - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe zëvendësministrin Hysen Durmishi, kanë vizituar Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Bashkëpunimi për ta avancuar sistemin për Menaxhimin e Trafikut Ajror ishte në qendër të takimit me Samir Bllacaku, drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe menaxhmentit të kësaj agjencie. Kryeministri Kurti ka theksuar rëndësinë që ka Menaxhimi i Trafikut Ajror në mënyrë që Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe kontrolli ynë ajror të arrijë në nivel të shteteve evropiane. "Do të bashkëpunojmë në muajt e vitet në vijim, në mënyrë që këtë agjenci shumë të rëndësishme për

infrastrukturën, për trafikun, për sigurinë dhe për sovranitetin e Republikës së Kosovës, ta shpijmë edhe më tej drejt arriturave të reja", ka thënë Kurti. Në veçanti, kryeministri ka vlerësuar mbështetjen e partnerëve dhënë për AShNAN, duke veçuar kontributin e NATO-s dhe KFOR-it. Ai ka shprehur bindjen që nëpërmjet bashkëpunimit të mëtutjeshëm do të përmbushen standardet më të larta, kriteret e Bashkimit Evropian. Drejtori Samir Bllacaku ka bërë me dije për përgatitjet teknike dhe profesionale që janë duke u bërë, në mënyrë që në të ardhmen të merret kontrolli i hapësirës së lartë ajrore, të asaj që është mbi 6250 metra. Nga kjo vlerësohet se përfitimet financiare si shtet të jenë ndërmjet 6 dhe 7 milionë euro në vit. U vlerësua hapja e dy korridore



të reja me Republikën e Shqipërisë që ka mundësuar shkurtimin e udhëtimit për në Vjenë për rreth 15 minuta, meqenëse më nuk është i nevojshëm kalimi në hapësirën e Republikës së Maqedonisë së

Veriut, çfarë ishte rasti më herët. Mes të arriturave u theksuan edhe zgjatja e pistës dhe niveli 3B i sistemit të aterimit, si nivel shumë i avancuar. Për ta parë nga afër procesin e

vëzhgimit dhe mbikëqyrjes, kryeministri Kurti vizitoi Kullën e Trafikut Ajror, Departamentin e Meteorologjisë, dhomën e operimeve dhe dhomën e monitorimit të pajisjeve aeronautike.

Emërohen bordet e drejtorëve të Trepçës dhe KEK-ut

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Qeveria në mbledhjen e saj të fundit ka marrë vendim që t'i emërojë bordet e drejtorëve të ndërmarrjes Trepça dhe të Korporatës Energetike të Kosovës. Kryesues i Bordit të Trepçës është emëruar Bahri Hyseni, Ibrahim Krasniqi, anëtar, Muharrem Peci, anëtar, Bujar Bilalli, anëtar dhe Xhevdet Tahiri, anëtar. "Në konkursin për Bordin Mbikëqyrës të Trepça SH. A., i shpallur nga Zyra e Kryeministrit, kanë aplikuar 57 kandidatë. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, komisioni përkatës ka përzgjedhur listën e ngushtë me 19 kandidatë. Për anëtarë të Bordit të Trepçës propozoj që të emërohen këta pesë



kandidatë: Bahri Hyseni, anëtar; Muharrem Peci, Xhevdet Tahiri, anëtar. Mandati kryesues; Ibrahim Krasniqi, anëtar; Bujar Bilalli, anëtar dhe i tyre zgjat katër vjet", ka thënë

kryeministri Albin Kurti. Për Bordin e KEK-ut, Kurti ka thënë se kanë aplikuar 72 kandidatë, teksa ka theksuar se komisioni ka përzgjedhur pesë anëtarë. Ndërsa për Bord të KEK-ut është emëruar Skënder Haziri kryesues; Merita Kasapolli, anëtare; Berzat Halili, anëtar; Valbona Raifi-Deshishku, anëtare; Mustafa Pllana, anëtar dhe Valdrin Krasniqi, anëtar. "Aktualisht i kemi dhjetë ndërmarrje me borde të përkohshme për të cilat do të ketë konkurs të rregullt të rekrutimit. Për secilën do të ketë thirrje dhe i ftoj profesionistët që t'i përcjellin konkurset tona dhe t'u përgjigjen atyre", ka thënë Kurti.

Miratohet raporti i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere me shumicë votash ka miratuar raportin me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin

e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, raport ky i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe

Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Kryetari i Komisionit, Armend Muja, ka thënë se ky projektligj nuk përmban ndikime shtesë buxhetore.



Cilat janë planet e Rosisë dhe Kinës për një rend të ri botëror

Nga Gideon RACHMAN
"Financial Times"

Aleanca perëndimore e ka kërcënuar Kremlinin me vendosjen e sanksioneve "të mëdha" dhe "të pashembullta", në rast se Rusia e sulmon Ukrainën. Por ndërsa kriza e Ukrainës po arrin "pikën e vlimit", përpjekjet e Perëndimit për ta izoluar dhe ndëshkuar Rusinë, ka të ngjarë që të dëmtohen nga mbështetja e Kinës, fqinjes gjigante të Rosisë.

Kur Vladimir Putin do të shkojë më 4 shkurt në Pekin, për të marrë pjesë në ceremoninë e fillimit të Lojërave Olimpikë Dimërore, presidenti rus do të takojë atje udhëheqësin që është bërë aleati i tij më i rëndësishëm, presidentin kinez Xi Jinping.

Gjatë një bisede telefonike mes të dyve në dhjetorin e vitit të kaluar, udhëheqësi kinez e mbështeti kërkesën e Rosisë, se Ukraina nuk duhet të anëtarësohet kurrë në NATO. Deri një dekadë më parë, një marrëdhënie e tillë dukej e pamundur, pasi Kina dhe Rusia ishin sa partnere aq edhe rivale.

Por pas një periudhe kur të dyja vendet janë përplasur vazhdimisht me SHBA-në, mbështetja e Xi-së për Putinin, pasqyrojnë një afërsi në rritje midis interesave dhe pikëpamjeve botërore të Moskës dhe Pekinit. Sipas mediave kineze, Xi i tha ndër të tjera Putinit, se "forca të caktuara ndërkombëtare po ndërhyjnë në mënyrë arbitrare në punët e brendshme të Kinës dhe Rosisë, nën pretekstin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut".

Sic e bënë të qartë komentet e Xi drejtuar Putinit, udhëheqësit rusë dhe kinezë janë të bashkuar nga bindja e përbashkët, se SHBA-ja po komploton për të sabotuar dhe përmbysur qeveritë e tyre. Në kulmin e komunizmit, Rusia dhe Kina mbështetën forcat revolucionare në mbarë botën.

Por sot Moska dhe Pekini kanë përqafuar retorikën e kundër-revolucionit. Kur shpërthyen trazirat në Kazakistan javët e fundit, Putin e akuzoi hapur SHBA-në se është përpjekur të sponsorizojë një "revolucion me ngjyra" – një term me të cilin përshkruhen lëvizjet protestuese që kërkojnë të ndryshojnë qeverinë – pikërisht në një vend që kufizohet me Rusinë dhe Kinën.

Ministrat kryesorë të qeverisë kineze, i bënë jehonë këtyre komenteve. Sipas këndvështrimit të Rosisë dhe Kinës, kryengritja në Kazakistan i përshtatej këtij modeli. Kremlinin ka argumentuar prej kohësh se SHBA-ja ka qenë "dora e fshehur" pas kryengritjes në Ukrainë, në të ashtuquajturin Revolucion i Maidanit gjatë viteve 2013-14, në të cilin u rrëzua nga pushteti një udhëheqës pro-rus.

Ndërkohë Kina këmbëngul se forcat e huaja – kryesisht SHBA –



qëndronin pas protestave të mëdha në Hong Kong gjatë vitit 2019, të cilat përfundimisht u shtypën me dhunë nga Pekini. Si Putin ashtu edhe Xi, e kanë bërë të qartë se besojnë se synimi përfundimtar i Amerikës është të rrezojë qeveritë aktuale ruse dhe kineze, dhe se forcat lokale pro-demokratike janë "Kuaj Troje" të Amerikës.

Në vitin 1917, presidenti amerikan Woodrow Wilson foli për "bërjen e botës të sigurt për demokracinë". Në vitin 2022, Putin dhe Xi janë të vendosur ta bëjnë botën të sigurt për autokracinë. Megjithatë ambiciet e Rosisë dhe Kinës, janë larg nga të qenit tërësisht dhe vetëm mbrojtëse.

Si Putin ashtu edhe Xi, besojnë se cenueshmëria e tyre ndaj "revolucioneve shumëngjyrëshe", buron nga të metat themelore të rendit botëror aktual, nga kombinimi i institucioneve, ideve dhe strukturave të pushtetit, të cilat përcaktojnë se si zhvillohet politika globale.

Rrjedhimisht, ata ndajnë së bashku vendosmërinë për të krijuar një rend të ri botëror, i cili do t'i përshtatet më mirë interesave të Rosisë dhe Kinës, siç përcaktohet edhe nga udhëheqësit e tyre aktualë.

Dy tipare të rendit botëror aktual, që kundërshtojnë shpesh rusët dhe kinezët, janë "unipolariteti" dhe "universaliteti". Thënë më thjesht: ata besojnë se marrëveshjet aktuale ndërkombëtare i japin shumë pushtet Amerikës, ndaj ata janë të vendosur ta ndryshojnë këtë realitet.

"Unipolariteti" nënkupton faktin se pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, bota mbeti me vetëm një superfuqi, SHBA-në. Analisti rus i politikës së jashtme, Fyodor

Lukyanov, i cili është shumë i afërt me presidentin Putin, beson se unipolariteti "i dha Shteteve të Bashkuara aftësinë dhe mundësinë, për të bërë gjithçka që e shih të arsyeshme në skenën botërore".

Ai pretendon se epoka e re e hegjemonisë amerikane, nisi që nga lufta e Gjirit Persik e vitit 1991, në të cilën SHBA ndërtoi një koalicion global, për të dëbuar nga Kuvajti ushtrinë irakiane të Sadam Husein.

Ajo luftë u pasua nga një sërë ndërhyrjesh ushtarake të udhëhequra nga SHBA në mbarë botën, përfshirë ato në Bosnje dhe Kosovë në vitet 1990. Bombardimi nga NATO i Beogradit, kryeqytetit të Serbisë, në vitin 1999, ka qenë prej kohësh pjesë e argumentit të Rosisë, se aleanca perëndimore nuk ka vetëm një mision mbrojtës.

Fakti që bombat e NATO-s ranë edhe mbi ambasadën kineze në Beograd, nuk është harruar ende në Pekin. Pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001 në Nju Jork dhe Uashington, NATO evokoi Nenin 5 – klauzolën e saj të mbrojtjes reciproke – dhe pushtoi Afganistanin. Sërish sipas Lukyanov, Amerika dëshmoi vullnetin dhe aftësinë e saj për ta "transformuar botën përmes forcës".

Por disfata e Amerikës në Afganistan, e simbolizuar nga tërheqja kaotike nga Kabuli verën e vitit të kaluar, i ka nxitur rusët të shpresojnë se rendi botëror i udhëhequr nga SHBA-ja është duke u shembur. Lukyanov mendon se rënia e Kabulit në duart e talebanëve, ishte "jo më pak historike dhe simbolike, sesa rënia e Murit të Berlinit".

Analistët kinezë më me ndikim janë në të njëjtën linjë me atë rusë. Yan Xuetong, dekan i shkollës së

marrëdhënive ndërkombëtare në Universitetin Tsinghua në Pekin (këshilltari i ngjishtë i Xi) shkruan se "Kina beson se ngritja e saj në statusin e fuqisë së madhe, i jep të drejtën të pretendojë një rol të ri në çështjet botërore, i cili nuk mund të pajtohet me dominimin e padiskutueshëm të SHBA-së."

Për Rusinë dhe Kinën, krijimi i një rendi të ri botëror, nuk është thjesht një çështje e fuqisë së ashpër, por edhe një betejë idesh. Ndërsa tradita liberale perëndimore, promovon idenë e të drejtave universale të njeriut, mendimtarët rusë dhe ata kinezë, përhapin argumentin se traditat kulturore dhe "civilizimet" e ndryshme, duhet të lejohen që të zhvillohen në mënyra të ndryshme.

Pekini dhe Moska, pretendojnë se rendi botëror aktual, karakterizohet nga një përpjekje e SHBA-së për t'i imponuar vendeve të tjera idetë perëndimore për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, nëse është e nevojshme edhe përmes ndërhyrjes ushtarake.

Ndërkohë, rendi i ri botëror që po kërkojnë të ndërtojnë Rusia dhe Kina, do të bazohet në sfera të ndryshme të ndikimit. Sipas vizionit të tyre, SHBA-ja do të duhet të pranojë dominimin rus dhe kinez në rajonet përreth tyre, dhe duhet të braktisë mbështetjen e saj për demokracinë ose revolucionet me ngjyra që mund të kërcënojnë regjimet e Putinit apo Xi.

Kriza ukrainase, është në fakt një luftë mbi rendin e ardhshëm botëror. Për Putin, Ukraina është kulturalisht dhe politikisht pjesë e sferës së ndikimit të Rosisë. Nevojat ruse për siguri, duhet t'i japin asaj të drejtën për të vendosur veton kundër çdo dëshirë të Ukrainës, për t'u

bashkuar me NATO-n dhe aleancën perëndimore.

Por nga ana tjetër për SHBA-në, kërkesa të tilla shkelin disa parime bazë të rendit aktual botëror, dhe sidomos të drejtën e një vendi të pavarur për të përcaktuar politikën e tij të jashtme dhe zgjedhjet strategjike. Kriza ukrainase ka lidhje me "rendin botëror", pasi ka pasoja të qarta globale.

SHBA-ja e di shumë mirë se nëse Rusia e sulmon Ukrainën dhe krijon "sferën e saj të ndikimit", do të krijohet një precedent për Kinën. Gjatë epokës së Xi, Kina ka ndërtuar baza ushtarake në të gjithë zonat e kontestuara në Detin e Kinës Jugore.


Kërcënimet e Pekinit për të pushtuar Tajvanin – një ishull autonom me një regjim demokratik, të cilin Kina e konsideron si një provincë rebele – janë bërë më të hapura dhe më të shpeshta.

Nëse Putin ia del të pushtojë Ukrainën, tundimi i Xi-së për të sulmuar Tajvanin do të rritet, ashtu si edhe presioni i brendshëm ndaj udhëheqësit kinez nga nacionalistët, që ndjejnë "fundin" e epokës amerikane.

Një rend i ri botëror, mund të shfaqet edhe përmes pranimit të heshtur nga Uashingtoni. Por ky rezultat nuk duket shumë i mundshëm me administratën Biden në pushtet, përveçse nëse do të ketë disa lëshime dramatike të minutës së fundit nga SHBA-ja në lidhje me Ukrainën.

Por edhe nëse Putin nuk ia arrin dot synimet e tij në Ukrainë, kërcënimi ndaj rendit botëror të udhëhequr nga SHBA nuk do të zhduket. Ai do të vijë me siguri nga një Kinë në rritje, e udhëhequr nga një president ambicioz si Xi Jinping.

Marrë me shkurtime/Bota.al



Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Curri për zhvillimet në FShF: Ndërhyrja e politikës do të ndikojë te Kombëtarja



TI Ranë, 2 SHKURT - Debatik Curri, ish-futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, ka analizuar zhvillimet e fundit në futbollin shqiptar. Më saktësisht është prekur ndikimi politik mbi zgjedhjet e reja të FShF-së. Curri është i sigurt se e gjitha kjo do të ndikojë së tepërmi te Kombëtarja dhe tek ekipet shqiptare. Ndërkohë nuk lihen pa përmendur edhe arrijtet e bëra në kohët e fundit nga futbollit shqiptar. "Ne që kemi luajtur për Kombëtaren, e përcjellim me mjaft interes këtë ngjarje që është duke ndodhur në Shqipëri dhe jam mjaft i shqetësuar për gjendjen dhe mënyrën se si po zhvillohet dhe po bëhet presion, siç e kam parë dhe është duke ndërhyrë politika në një garë, që është e ndaluar nga UEFA, që e ka cekur se gjëja kryesore që nuk

duhet të bëhet është ndërhyrja e politikës. Çdo garë e ndershme, që bëhet me një kandidat që kandidon dhe dëshiron të bëhet kryetar federate, është e pranueshme, por jo në mënyrat që po zhvillohet tani. Presidenti që është edhe tani, i cili ka bërë një punë të mrekullueshme prej vitesh dhe mendoj se është njeri me edukatë për ta udhëhequr federatën edhe për shumë vite të tjera", ka thënë Curri.

"FShF-ja është një institucion që është si një lloj shtëpie për çdo futbollist. Sa i përket Armand Dukës, është një ndër personat që ka investuar më shumë në infrastrukturë dhe është duke investuar. Çdo skuadër në Shqipëri ka një stadium. Kjo ndërhyrje do të ndikojë edhe te klubet e tjera. Shpresoj që do të ndalen

këtu, sepse ka pasur indikacione dhe më herët, për ndërhyrje të politikës. Po shpresoj që kjo të mos ndodhë as në Shqipëri, as në Kosovë e as në ndonjë vend tjetër", ka shtuar Curri për emisionin "Breaking" në "Top News", ku foli edhe për drejtimin e Dukës në krye të FShF-së. "Duka është një njeri që e ka bërë punën mjaft mirë deri tani dhe shpresojmë që të vazhdojë dhe më tej të ketë këtë qasje që ka pasur deri tani. Mendoj që është një person që e meriton të jetë aty dhe ta lejojnë të zhvillojë projektet që i ka për katër vitet e ardhshme. Shpresojmë që këto fjalë tonat t'i kuptojnë njerëzit dhe të kuptojnë njëherë e mirë që njerëzit që punojnë duhet të udhëheqin gjithmonë dhe të vazhdojnë projektet që kanë", ka deklaruar Curri.

SHKURT

Ballkani përforcohet me ish-lojtarin e Twentes, Dilivio Hoffman

Skuadra e Ballkanit është përforcuar me një lojtar nga kampionati holandez. Fjala është për Dilivio Hoffman, i cili më parë ka luajtur për Twenten. Sulmuesi 24-vjeçar ka firmosur kontratën me Ballkanin deri në verën e vitit 2024. "Futboll Klub Ballkani ka kënaqësinë të njoftojë se sulmuesi anësor Dilivio Hoffman është zyrtarisht pjesë e skuadrës sonë. Sulmuesi 24-vjeçar ka firmosur kontratën me skuadrën tonë deri në verën e vitit 2024 duke u bërë në këtë mënyrë përforcimi më i ri i skuadrës sonë. Në të shkuarën Hoffman ka luajtur në kampionatin holandez me ekipe si FC Twente U21, Den Bosch U21, De Treffers si dhe, së fundmi, ishte pjesë e Tec", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Shaqiri, pas golit me kokë: U çudita edhe unë me veten

Futbollisti Xherdan Shaqiri shënoi gol me kokë në ndeshjen që Lyoni e fitoi me përmbysje ndaj Marseilles (2-1). Futbollisti shqiptar realizoi edhe një asistim, duke qenë lojtar i ndeshjes. Pas ndeshjes, Shaqiri ka thënë se e ka befasuar edhe veten me golin që e shënoi me kokë. "Është e jashtëzakonshme ajo çfarë bëri ekipi sonë. Shumë lojtarë munguan, të lënduar. Jam krenar me ekipin. Jam shumë i lumtur me paraqitjen dhe shumë i lumtur me këtë ekip. Është gol i rëndësishëm me kokë. Edhe unë jam i habitur (qesh). Harkimi ishte shumë i mirë nga Malo. Ne punojmë shpesh për këtë në stërvitje. Jam i lumtur me shënimin e këtij goli", ka thënë Shaqiri.

Morina përforcon Trepçën '89

Ish-kapiteni i Vëllaznimit, Albutrint Morina, edhe zyrtarisht është pjesë e skuadrës së Trepçës '89. Lajmin e ka dhënë vetë klubi mitrovicas në faqen zyrtare në "Facebook". "Albutrint Morina është zyrtarizimi më i ri i klubit. Mesfushori me përvojë mjaft të madhe në elitën e futbollit kosovar iu bashkohet 'Minatorëve' në rrugëtimin tonë për t'u rikthyer në elitën e futbollit të Kosovës", thuhet në njoftimin e 89-shit. Albutrint Morina ka luajtur edhe për Feronikelin, FC A&N Prizren, Llapin dhe Drenicën.

Uzuni pritet të debutojë ndaj Realit në fundjavë

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Myrto Uzuni, merr një lajm fantastik pasi firmosi kontratën me skuadrën e Granadas. Sulmuesi kuqezi mund të debutojë në La Liga këtë fundjavë, në ndeshjen që skuadra e tij do të luajë kundër Realit të Madridit. Nëse gjithçka do të shkojë mirë në seancat stërvitore, atëherë aventura e Uzunit në Spanjë do të niste në mënyrën më fantastike të mundshme. Uzuni u ble nga Granada për 3,5 milionë euro, me sulmuesin që mbylli aventurën te Ferencvaros me 36 gola dhe 14 asistime në 67 ndeshje.

KOK-u ndan nga 150 euro për 17 shpresat olimpike

PRISHINË, 2 SHKURT - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës ka aprovuar rekomandimin e komisionit të sportit për përzgjedhjen e 17 shpresave olimpike 2022 të cilat vijjnë nga 10 federata. Përzgjedhja është bërë bazuar në rezultatet e tyre, gjithëpërfshirjen dhe

universalitetin. Bursistët do të mbështeten nga KOK-u me nga 150 euro secili, duke rritur shumën e mbështetjes nga vitet paraprake. Lista pritet të zgjerohet në ditët e ardhshme, pas aplikimit të ri që do ta bëjnë federatat e sporteve olimpikë. Bursistët u takojnë moshave 15-21 vjeç.

Lista e sportistëve: Anes Veseli, Dardan Cena, Luan Morina, Aja Broqi, Mal Sahiti, Sulejman Vizdıklar, Florentina Restelica, Floriana Berisha, Yllka Jashari, Agnesa Koxha, Egzon Xhoni, Ndrëçim Raçi, Edonit Tëllaku, Alma Mehmeti, Kreshnik Mahmuti, Valëza Rama, Elvis Çitaku.



Marquezi: Do të më pëlqente të kthehesha kampion si Nadali

Cervera, 2 shkurt - Marc Marquezi mori "ok"-in e mjekëve për të zbritur në pistë këto ditë në testet dimërore të MotoGP që po zhvillohen në pistën e Sepang (Malajazi). Piloti spanjoll i Hondas nuk ka më probleme me shikimin, që

e penguan të marrë pjesë në dy garat e fundit të vitit të kaluar. "Problemi me syrin tashmë është i rikuperuar 100 %, por ajo që më shqetëson më shumë është krahu i operuar. Duhet të bëj një planifikim shumë të detajuar

për të bërë të mundur që të kem sa më pak dhimbje dhe t'i limitoj problemet", u shpreh Marc Marquez për "Marca". Pra, problemet fizike duket se do të jenë sërish një ngërç për kampionin e botës në MotoGP, që mund të mos arrijë nivelet e

dëshiruara. "Do të më pëlqente të kthehesha kampion si Nadali, që të triumfoj sërish në fund të sezonit. Ajo që bëri ai më motivon për sezonin e ri", ka deklaruar Marquezi.



Rugova largohet nga FBK-ja, emërohet drejtor i sportit në Prishtinë

PRISHTINË, 2 SHKURT - Granit Rugova është larguar nga pozita e drejtorit në Përfaqësuesen e Kosovës dhe nga ushtruesi i detyrës së drejtorit në Ligën Unike. Me anë të një komunikimi në rrjetet sociale, Granit Rugova, ish-basketbollisti i shumë skuadrave të ndryshme në Kosovë, ka njoftuar opinionin se tani do ta ketë një profesion tjetër në karrierën e tij. Rugova tani do të udhëheqë Drejtorinë e Sportit në Komunën e Prishtinës. "Pas një përvoje të jashtëzakonshme në Federatën e Basketbollit të Kosovës, erdhi koha e ndryshimit. Falënderoj të gjithë për besimin ndaj meje, në veçanti kryetarin Arben Fetahu, sekretaren e përgjithshme Elvira Dushku, bordin e FBK-së dhe të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët për këtë periudhë trevjeçare e gjysmë.



Puna si drejtor i Përfaqësuesve të Kosovës ishte shumë sfiduese, por u përpoqa dhe dhashë maksimumin. Ishte nder dhe krenari për mua, ashtu siç e kam veshur fanellën e Prishtinës dhe Kosovës ndër vite. U. d. i drejtorit Ekzekutiv të Ligës Unike për mua ishte përgjegjësi, por edhe krenari, të punoja për një ligë që bashkon Kosovën dhe Shqipërinë. Njëra sfidë ka

mbaruar, tjetra po fillon... Dua t'ju njoftoj se Uran Ismaili dhe Partia Demokratike e Kosovës më ka besuar ta udhëheq Drejtorinë e Sportit në komunën e Prishtinës. Me kënaqësi e kam pranuar këtë detyrë dhe pa dyshim se do të kontribuoj në promovimin dhe avancimin e sportit në qytetin tim të zemrës", ka shkruar Rugova në profilin e vet në "Facebook".

Dele Alli: Mezi pres të punoj me Lampardin

LIVERPOOL, 2 SHKURT - Evertoni ka nënshkruar një marrëveshje për dy vjet e gjysmë me Dele Allin, i cili transferohet nga Tottenhami, për një tarifë e cila mund të arrijë vlerën e 40 milionë eurove. Tekniku Frank Lampard u shpreh se është koha që mesfushori Alli të rilindë në karrierën e tij pas një ngërçi që ka pasur vitet e fundit te Tottenhami. "Jam shumë i lumtur që kam nënshkruar për Evertonin, një klub i madh me një histori dhe tifozë të shkëlqyer. Jam i etur për të filluar dhe mezi pres ndeshjen time të parë me fanellën e Evertonit. Mezi pres ta ndihmoj ekipin dhe të punoj me trajnerin e ri Frank Lampard", ka deklaruar Dele Alli.

Pritet që mesfushori, i cili vjen nga Tottenhami, ta kryejë debutimin e tij më 8 shkurt kundër Newcastle



në Premierë Ligë. Me "Spurs", Alli shënoi 67 gola në 269 ndeshje të luajtura. 25-vjeçari, i cili ka luajtur 37 herë për Anglinë, ka luajtur gjashtë ndeshje nën drejtimin e trajnerit Antonio Conte, që pas mbërritjes së italianit në nëntor. Mesfushori me tipare sulmuesi ka luajtur gjashtë ndeshjet hapëse në

Premierë Ligë të sezonit aktual gjatë periudhës së Nuno Espirito Santo në bankinën e Tottenhamit. Alli shënoi 10 gola në 33 ndeshje gjatë sezonit të tij në Premierë Ligë përpara se ta prekte shifrën e 18 golave në sezonin 2016-17, duke e bërë kështu atë fitues të dy çmimeve PFA (Lojtari i Ri i Vitit).

SHKURT

Presidenti i UEFA-s zbarkon në Tiranë, takime me Ramën dhe Dukën

Presidenti i UEFA-s, Alexander Ceferin, do të mbërrijë ditën e enjte për një vizitë zyrtare në Tiranë. Kreu i qeverisë së futbollit evropian do të zhvillojë një takim në orën 15:00 me kryeministrin Edi Rama dhe më pas do të pritë në takim nga presidenti i FShF-së, Armand Duka. Në dy takimet pritë të diskutohet për problematikat e incidenteve të fundit lidhur me procesin zgjedhor të FShF-së dhe në lidhje me organizimin e finales historike të UEFA Europa Conference League në stadiumin "Air Albania" më 25 maj.

Aubameyangu kompletion transferimin te Barcelona

Sulmuesi Pierre-Emerick Aubameyang edhe zyrtarisht është lojtar i Barcelonës. Katalanasit firmosën me sulmuesin nga Gaboni, një kontratë deri në vitin 2025 por, gjithashtu, edhe me opsion largimi më 30 qershor 2023, ku do të ketë një klauzolë përfundimi prej 100 milionë eurosh. Aubameyangu mbërriti në "Camp Nou" pasi u largua nga Arsenali pas marrëdhënieve të tensionuara me trajnerin Mikel Arteta që i hoqi shiritin e kapitenit dhe e la jashtë skuadrës.

Chelsea nuk e shet Brojën

Armando Broja po kalon një çast fantastik në Premierë Ligë, lider absolut te Southamptoni. Forma e sulmuesit kuqezi tërhoqi vëmendjen e shumë klubeve që u përpoqën t'ia rrëmbenin Chelsea talentin. Nga Southamptoni te Newcastle, për të vijuar me West Hamin etj., të gjithë vendosën kontakte me blutë për të kuptuar nëse ekziston mundësia për ta blerë kartonin e Brojës. Sipas medieve angleze, Chelsea ka vendosur të refuzojë çdo ofertë që vjen në drejtim të Brojës pasi dëshira e trajnerit Tuchel është t'i japë një tjetër shans sulmuesit shqiptar. Broja do ta përfundojë huazimin te Southamptoni deri në fund të sezonit për t'u rikthyer më pas sërish në Londër, skuadër me të cilën ka një kontratë deri më 2026. Edhe më herët, kur është pyetur për Brojën, Tuchel ka qenë i prerë, situata e tij do të vlerësohet vetëm në fund të këtij sezoni, për të dalë më pas me një vendim final. Fakt është që sulmuesit Tuchel, Lukaku e Timo Werner nuk po kalojnë çaste të mira. Kjo është një tjetër arsye e fortë pse Chelsea ka refuzuar çdo ofertë që ka ardhur deri më tani në drejtim të Brojës.

Ish-presidenti i Barçës: Mbappe ka nënshkruar për Realin

Ish-presidenti i Barcelonës, Joan Gaspart, është i sigurt që ylli i PSG-së, Kylian Mbappe, ka nënshkruar me Real Madridin. Mediumi gjerman "Bild" raportoi para disa ditëve që francezi ka nënshkruar me "Los Blancos", ku do të fitojë 50 milionë euro për sezon. Ndërkohë, Gaspart derisa ishte në intervistë për "Marca" theksoi se Kylian Mbappe ka nënshkruar me Real Madridin. Jam i sigurt. E njoh Florentinon dhe jam shumë i sigurt", ka thënë ai. Ndërkohë, raportohet se marrëveshja nuk është bërë publike shkaku që PSG dhe Real Madridi takohen në kuadër të Ligës së Kampionëve në raundin e 16.

Wolffi: Kam menduar largimin nga Mercedesi, por në fund ndryshova mendjen

Që kur është bërë drejtor sportiv i Mercedesit, Toto Wolff, ka arritur të fitojë tetë tituj kampionë për konstruktorë dhe shtatë për pilotë në Formula 1. Megjithatë,

aventura e tij te makina gjermane nuk ka qenë kaq e lehtë dhe këtë gjë e konfirmon vetë numri 1 i Mercedesit. Vitit 2020 apo dhe ai 2021 që u mbyll me shumë polemika kanë

qenë të vështirë për Wolffin. Ai konfirmon se ka qenë pranë largimit nga Formula 1. "Kam dhënë gjithçka te Mercedesi gjatë këtyre tetë viteve dhe muajt e fundit apo edhe ato

gjatë vitit 2020 kanë qenë të ndërlikuar për mua", ka thënë Wolff. "Shpesh kam pyetur veten nëse dua apo jo të qëndroj në Formula 1? A mund të jap ende kontributin tim,

apo dikush tjetër mund ta bëjë atë më mirë? Në fund vendosa të qëndroj në Formula 1 dhe të jap kontributin tim me Mercedesin", ka shtuar Toto Wolff.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë/03/02/2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, shpallë:

KONKURS

- 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek. XX - zgjedhje
2. 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për periudhën osmane (osmanolog) – zgjedhje

Kandidatët për bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku një punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbokroate është përparësi,
 - Pozicioni nr.2 duhet të njohë gjuhën osmane.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512-303, prej orës 09:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e re e Institutit të Historisë në afërsi të Institutit Albanologjik të Prishtinës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 03.02. 2022

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno istraživačkoj djelatnosti - (Službeni List Republike Kosova, br. 11/02 Maja 2013), člana 30 Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u

Prištini, člana 32 Zakona br. 03/L-212 o Radu, Administrativnog Uputstva (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, i Pravilnika o postupku izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača Istorijskog instituta, objavljuje:

KONKURS

- 1 (Jedan) Naučni saradnik za XX vek - izbor
2. 1 (Jedan) Naučni saradnik za osmansko doba (osmanolog) - izbor

Kandidata za naučnog saradnika moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje jedan naučni rad objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti,
- da je učestvovao u naučnim aktivnostima u zemlji i van zemlje,
- Znanje engleskog i srpskohrvatskog je prioritet,
 - Pozicija br. 2 mora znati osmanski jezik

Potrebna dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diploma o završenim relevantnim studijama,
- izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.

Izbor osoblja Instituta Istorija "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L - 135 za istraživačke- naučne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri".

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izbornoj listi će biti obavešteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br. Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Novi Objekat u blizini Instituta Albanologjik i Prishtinës).

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "NMA" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e materialeve izoluese & dekorative nga stiropori.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 24.02.2022 në ora 10:00 në Restorant ONIX PALACE në adresë Rruga Prishtinë Obiliq (te rrethi rrugës për në Obiliq) do të organizohet debat publik nga Kompania "NMA" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e materialeve izoluese & dekorative nga stiropori.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Linku: <https://us05web.zoom.us/j/8299721574?pwd=MUVGRINTdFU2eVRKNUNkSWtNaWE5dz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "NMA" Sh.p.k. Prishtinë, për fabrikë për prodhimin e materialeve izoluese & dekorative nga stiropori.

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ekrem Shema, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, me nr: KO-01924-01-12.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalitë me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues